



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 mars 2016
Nr. ref.:RK908/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI120/15

Parashtrues

Refki Bytyqi

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I-14-0220-A001-A0013 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 21 majit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Refki Bytyqi, nga fshati Randobravë, komuna e Prizrenit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin AC-I-14-0220-A001-A0013 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme), të 21 majit 2015, i cili i është dorëzuar atij më 8 qershor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, me të cilin, siç pretendohet, janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 6 tetor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. GJR. KI120/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI120/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 23 nëntor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 10 shkurt 2016, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ka qenë punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore "Industria Ushqimore" (në tekstin e mëtejme: NSH) deri në vitin 1998, kur për shkak të lëndimit në vendin e punës doli në pension invalidor.
10. Më 2 gusht 2011, NSH u privatizua.
11. Më 3 maj 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Agjencia e Privatizimit) publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të cilët e

kishin fituar të drejtën për një pjesë të të ardhurave të realizuara nga privatizimi i NSH-së, në të cilën nuk gjendej parashtruesi i kërkesës.

12. Më 25 maj 2012, parashtruesi ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) ndaj listës përfundimtare të Agjencisë së Privatizimit.
13. Më 22 qershor 2012, Agjencia e Privatizimit u përgjigj në ankesën e parashtruesit të kërkesës duke theksuar se *“ai nuk i përmbush kushtet për realizimin e të drejtave në pajtim me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/ 13, prandaj, i propozon Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme) ta refuzojë ankesën e parashtruesit si të papranueshme”*.
14. Më 16 maj 2014, Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin [C-U-120018], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, me arsyetimin se: *“Në bazë të dokumenteve të bashkëngjitura të dorëzuara nga parashtruesi dhe Agjencia e Privatizimit, mund të konkludohet se parashtruesi prej vitit 1998 është në pension invalidor, dhe në bazë të kësaj ai nuk ka mundur të përmbush kriterin e paraparë në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13”*.
15. Më 25 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme [C-U-120018].
16. Në ankesë, parashtruesi i kërkesës theksoi se Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme e kishte vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale, dhe se Aktgjykimi ishte kontradiktor dhe konfuz.
17. Më 21 maj 2015, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin [AC-I-14-0220-A001-A0013] me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të palejuar, me arsyetimin se *“Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme ka vendosur drejtë kur ankesën e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar, sepse ai nuk kishte arritur t'i përmbush kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi në kërkesë theksoi se *“Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme i ka shkelur të drejtat për barazi të gjykimin, të garantuara me nenin 31. të Kushtetutës”*.
19. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që *“të anulohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme dhe Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme si kundërkushtetuese dhe kundërligjore, si dhe të obligohet Agjencia e Privatizimit ta përfshijë në listën përfundimtare të punëtorëve të cilët e realizojnë të drejtën për 20% nga privatizimi”*.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Në mënyrë që të jetë në gjendje të zgjidhë ankesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ankesa i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës, përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

22. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit parasheh si në vijim:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

23. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, që parasheh:

(1) *“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) *Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

24. Duke i analizuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar ankesën e tij kushtetuese mbi pretendimet për shkelje të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës, i cili për nga përmbajtja korrespondon me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

25. Në rastin konkret, Gjykata gjen se Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme, e më vonë edhe Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme, i kanë bazuar aktgjykimet e veta në dispozitat ligjore të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ku thuhet:

“Punëtori ka të drejtë në një pjesë të 20% të të hyrave nga shitja nëse ai ka qenë i evidentuar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit/likuidimit dhe nëse ka qenë në listën e pagave të NSH-së për jo më pak se tri vite. Punëtori i cili nuk i plotëson këto kushte megjithatë mund të ketë të drejtë për 20% nëse vërtetohet se diskualifikimi i tij është bërë në bazë diskriminuese”.

26. Prandaj, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta gjetën se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur t'i përmbushë kërkesat procedurale të përcaktuara me ligj, dhe rrjedhimisht ai nuk mund të gjendet në listën e punëtorëve të kualifikuar të cilët e kanë fituar të drejtën për 20 (njëzet) për qind nga privatizimi.
27. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se parimi i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm kërkon që gjykatat t'i referohen normës së caktuar juridike, ndërsa baza juridike e aktgjykimit nuk duhet të jetë arbitrare, pra jashtë lëndës konkrete, dhe, sipas mendimit të Gjykatës, gjykatat e rregullta i janë përmbajtur kësaj gjatë procedurës së rregullt.
28. Për më tepër, Gjykata vlerëson se Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme kishte dhënë konkludime të qarta dhe të sakta në Aktgjykimin [C-I-14-0220-A001-A0013], të bazuara në interpretimin i cili është i pranueshëm sipas Kushtetutës dhe në zbatimin e të drejtës relevante, mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në procedurën gjyqësore.
29. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e veta dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih Rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesi *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).
30. Si përmbledhje, Gjykata është e mendimit se në procedurën e zbatuar nuk ka fakte apo rrethana të cilat në ndonjë mënyrë do të tregonin se parashtruesit të kërkesës, në procedurat që i paraprinë procedurës në Gjykatë, i janë shkelur të drejtat e njeriut apo liritë e garantuara me Kushtetutë ose me KEDNJ. Prandaj, Gjykata gjen se referenca për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës është e pabazuar.
31. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

